

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Komuna e Vitisë

Si të veprohet në kërkesën për qasje në lidhje me konkursin për infermiere, respektivisht se cilat të dhëna konkrete janë të mbrojtura me ligj dhe nuk duhet lejuar qasja në ato dokumente. Dokumentet e kërkuara ndërlidhen me konkursin; listën me poena nga testi me shkrim dhe me gojë; listën e kandidatëve që kanë plotësuar kushtet e konkursit; rezultatet definitive dhe vendimin për përzgjedhje.

Kërkesa jonë për këshillë ka të bëjë me diplomën e shkollës së mesme, licencën e punës, testin me shkrim dhe me gojë dhe kërkesën për CV e të gjithë kandidatëve.

AIP / ShQDP

Kërkesa për qasje në dokumente publike që ju është drejtuar juve, në vete ngërthen elemente që duhen trajtuar edhe sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Jetëshkrimet (CV) e kandidatëve të suksesshëm mund t'i ofrohen palës kërkuuese, por duke pseudonimizuar apo anonimizuar të dhënat personale të tepërta, si nr. personal (nëse ka), adresa fizike dhe/apo elektronike personale, nr. i telefonit (nëse ka), apo edhe ndonjë e dhënë tjetër personale, që sipas gjykimit të zyrtarit përgjegjës (ZKA i DSHMS-së) mund të konsiderohet si e ndjeshme apo e tepërt; Të dhënat (rezultatet) e testimit dhe intervistimit mund t'i ofrohen palës kërkuuese, duke u bazuar në atë se dokumenti, në të cilin shpalosen rezultatet, është forma standarde që e përdorin institucionet gjatë procesit të rekrutimit dhe lidhet me marrëdhëniet e punësimit të zyrtarëve publikë, në vete përmbanë të dhëna personale, si: emrat e kandidatëve dhe të anëtarëve të komisionit që në parim nuk i nënshtrohen ndonjë kufizimi të përpunimit të të dhënave dhe nuk do të cenonin dinjitetin e subjektit, por do t'i shërbente edhe më tepër transparencës. Këto të dhëna janë të publikuara në web faqen e Komunës së Vitisë me rastin e publikimit të rezultateve. Dhënia e rezultateve të testimit dhe intervistimit që ju kanë bërë kandidatëve mund të j'u jipen në formë statistikore palës kërkuuese dhe për këtë konsiderojmë se qasja në këto rezultate i shërben interesit thelbësor publik, ngase interesi i përgjithshëm publik është rritja e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.

Qasje në ankesa dhe përgjigje të ankesave mund t'i ofrohen palës vetëm në të dhëna statistikore, pra, numri i përgjithshëm i ankesave dhe përgjigjeve të kthyera.

Qasja në të dhënat e plota (në rastet kur është rekomanduar pseudonimizimi apo anonimizimi për shkak të të dhënave të ndjeshme apo të tepërta eventuale) të dokumentacionit të lartpërmendur mund të ofrohet nëse zyra e personelit të DSHMS-së merr pëlqimin paraprak nga subjektet e të dhënave për t'i ndarë ato të dhëna me palët e treta.